


UNIVERSITETI BARLETI

PROSPECTUS

UNIVERSITETI EKSELENCËS



Aplikativ & Sipërmarrës

www.umb.edu.al



PSE TË ZGJIDHNI UNIVERSITETIN "BARLETI"?

4 Fakultete

13 Departamente

40+ Programe studimi

25+ Iniciativa & Qendra

350+ Marrëveshje bashkëpunimi

1500+ Aktivite

5 Institute

6000+ Studentë të diplomuar

Nivelet e studimit në Barleti

Certifikata | Programe Profesionale | Bachelor | Master Profesional | Master i Shkencave | Programe të Integruara | Doktoratë në Shkencat Ekonomike dhe Juridike

20 VITE "BARLETI" - UNIVERSITETI QË RRIKET ME TY

Universiteti "Barleti", i themeluar në vitin 2005, vijon prej dy dekadash të zhvillohet si një universitet modern, sipërmarrës dhe i orientuar drejt së ardhmes. Gjatë këtyre viteve, Barleti ka zgjeruar ndjeshëm ofertën e tij ndërdisiplinore, duke u fokusuar në fushat më të kërkuara nga tregu dhe shoqëria: shkencë mjekësore, biznes, ekonomi dhe financë, drejtësi, teknologji informacioni, mësuesi në sporte, dizajn dhe industri kreative, shkencë sociale, arkitekturë, urbanistikë dhe fusha të tjera të lidhura.

Qasja jonë është praktike dhe e bazuar në përvojë reale: studimet shoqërohen me projekte konkrete, praktika profesionale, kërkim shkencor, iniciativa komunitare dhe bashkëpunime me partnerë vendas e ndërkombëtarë. Kjo u ofron studentëve mundësinë të ndërtojnë portofolin e tyre profesional gjatë viteve të studimit.

Përveç programeve Bachelor dhe Master, Universiteti "Barleti" ofron edhe studime të doktoraturës në Shkencat Ekonomike dhe Juridike, duke krijuar një mjedis unik ku formimi akademik, kërkimi dhe praktika profesionale ndërthuren në një ekosistem të vetëm.

"Barleti" është zgjedhja e duhur për maturantët dhe profesionistët që kërkojnë një ambient bashkëkohor, të aksesueshëm dhe të orientuar drejt karrierës, ku fakultetet, programet dhe partneritetet funksionojnë së bashku me një qëllim të qartë: formimin e profesionistëve të aftë, të përgjegjshëm dhe konkurrues në treg.



Prof. Dr. Suzana Guxholli
Rektore e Universitetit Barleti

Është një kënaqësi e madhe dhe fat i veçantë, një emocion i rrallë, që kam rastin dhe fatin t'ju uroj mirëseardhjen në Universitetin Barleti si drejtuese e tij, në një moment të veçantë për të, që jo vetëm ka inauguruar një kampus të ri modern, por edhe ka materializuar e shprehur, nëpërmjet tij, vizionin e ri, fazën e re të zhvillimit të tij si universitet aplikativ dhe sipërmarrës.

Sot jetojmë në një kohë kur bota, dhe arsimi i lartë bashkë me të, po kalojnë transformime shpërthyes; ku dija rritet e ndryshon me një shpejtësi marramendëse; kur rëndësia e saj në adresimin e problemeve të botës është e padiskutueshme; dhe kur teknologjia ofron mundësi pa kufij. Universiteti Barleti ka perceptuar dhe përqaftuar këto ndryshime, si në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies së dijes, ashtu edhe në fushën e kërkimit të aplikuar.

Universiteti Barleti është zemra e Grupit Barleti, që përfaqëson një sistem ku bashkëveprojnë shumë struktura, të cilat së bashku krijojnë një hapësirë dhe qendër dijesh, ku farkëtohen aftësi e kompetenca të reja teknologjike e profesionale, ku ngjizen dhe lindin ide që çojnë në inovacion.

Kampusi i ri, kozmopolitan, sipërmarrës dhe i hapur, dëshmon për qasjen ndaj perspektivës afatgjatë të zhvillimit, që pasuron formimin universitar dhe përfaqësohet në kurrikulat e formimit akademik dhe profesional. Kampusi i ri nuk është thjesht një godinë apo një ambient universitar, por një instrument dhe strehë e vërtetë e ëndrrave që bëhen realitet.

Në UniBa, ju gjeni jo vetëm një vend ku do të merrni dije të reja, por edhe ku do të nxisni e rrisni ide të reja; ku, si Barletas, jo vetëm do të formoheni, por edhe do të kontribuoni në zhvillimet e ditës dhe do të krijoni lidhje të reja profesionale e miqësore.

Së bashku me akademikët, përfaqësues të biznesit, të qeverisjes dhe të shoqërisë civile, ju studentët do të punoni në auditore dhe jashtë tyre, për të hyrë në probleme dhe zgjidhje konkrete, nëpërmjet të nxënimit eksperimental dhe shumëdisiplinor.

Pra, në edukim dhe kërkim, në kontekstin global, Universiteti Barleti punon të sjellë botën brenda tij dhe të mundësojë studentët dhe stafin akademik të hyjnë në botën globale.

Universiteti Barleti projektohet si mundësi për të ardhmen, për karriera në ndryshim, për mënyrën se si brezat pasardhës do të përqaftohen dhe do të mendojnë mbi të nxënimit dhe zhvillimin profesional.

UniBa është një qendër dijesh ku mund të takosh dhe të bëhesh sipërmarrës, politikan apo aktivist shoqëror; një hapësirë komunitare e hapur që mishëron ide të reja në shumë fusha, aplikacione, sipërmarrje dhe aktivizëm shoqëror, politik e kulturor.

Këtu, në Universitetin Barleti, secili gjen një vend ku mund të mendojë dhe veprojë, të imagjinojë dhe të realizojë. Universiteti Barleti nuk ka dilema midis të zakonshmes dhe së resë, traditës dhe ndryshimit.



Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë

Mesazhi i Dekanit Prof. Asoc. Dr. Arbi Agalliu

Pse të studioni në Fakultetin e Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë në Universitetin Barletti?

Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë në Universitetin Barletti është një nga mjediset akademike më dinamike, ku studimet ndërthuren ngushtë me praktikën dhe kërkesat reale të tregut të punës.

Programet tona janë konceptuar për të zhvilluar tek studentët aftësi profesionale, analitike dhe praktike, të cilat janë shumë të kërkuara në sektorin privat, publik dhe atë ndërkombëtar. Si universitet aplikativ dhe inovativ, me një staf akademik dhe profesionistë aktivë në industri, studentët përfitojnë njohuri të përditësuara dhe të zbatueshme menjëherë në praktikë.

Fakulteti ka ndërtuar partneritete me institucione shtetërore, kompani private, organizata joqeveritare dhe sipërmarrje të ndryshme, duke i hapur studentëve dyer për praktika profesionale, projekte reale dhe mundësi punësimi gjatë dhe pas studimeve.

Përmes metodave moderne të mësimdhënies, punës në grup, simulimeve, laboratorëve profesionalë dhe qasjes ndërdisiplinore, studentët përgatiten të jenë konkurrues për tregun e punës.

Ne synojmë që të zhvillojmë tek studentët aftësi në financë, menaxhim, qeverisje, drejtësi, sipërmarrje, politikë publike, marketing, inovacion dhe fusha të tjera kyçe, duke u formuar si liderë të rinj që ndikojnë pozitivisht në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror.

Zgjedhja e këtij fakulteti do të thotë të investoni në një arsim më cilësor, më praktik dhe të orientuar drejt së ardhmes.

Universiteti Barletti, si universitet aplikativ dhe sipërmarrës, ju ndihmon të ndërtoni karrierën tuaj hap pas hapi, duke filluar që nga dita e parë e studimeve.



Fakulteti i ideve që kthehen në politika, ligje dhe biznese.

DEPARTAMENTI I EKONOMISË, SIPËRMARRJES DHE FINANCËS

Bachelor

- Financë – Kontabilitet
- Menaxhim Biznesi
- Marketing, Publicitet dhe Marrëdhënie me Publikun
- Financë dhe Teknologji (FinTech)

Master Profesional

- Lidërsip dhe Menaxhim Burimesh Njerëzore
- Marketing dhe Menaxhim Operacionesh

Master i Shkencave

- Kontabilitet
- Financë dhe Teknologji (FinTech)
- Menaxhim dhe transformim digjital

Diplomë Profesionale

- Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje



DEPARTAMENTI I QEVERISJES, SHKENCA POLITIKE DHE KOMUNIKIM

Master i Shkencave

- Politika Evropiane dhe Administrim Publik



DEPARTAMENTI I DREJTËSISË

Diplomë e Integruar

- Drejtësi (5 vjet – Program i Integruar)

Master i Shkencave

- E Drejtë Tregtare
- E Drejtë Penale dhe Kriminologji



Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative

Mesazhi i Dekanit Prof. Asoc. Dr. Saimir Kristo

Në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative, ne besojmë se edukimi duhet të jetë një proces real, i prekshëm dhe i orientuar drejt së ardhmes. Programet tona ndërtohen mbi një filozofi bashkëkohore që ndërthur teorinë me praktikën, kreativitetin me teknologjinë, dijen akademike me eksperiencën profesionale në terren. një treg pune që transformohet çdo ditë. Fakulteti ynë nuk është një ishull i izoluar, as një kështjellë me mure rrethuese të ngritura mbi autoreferencë. Përkundrazi, ne besojmë se një fakultet i shkencave të aplikuara dhe industrive kreative duhet të jetë si një far: një dritë që ndriçon dijen, përcjell besim, afron varkat dhe anijet drejt tij, por njëkohësisht i lejon të largohen të lira për të eksploruar arkipelagë idesh, dete të reja sfidash dhe oqeanë të mundësive profesionale.

Qëllimi ynë është t'u japim studentëve mjetet, aftësitë dhe vetëbesimin për të projektuar karrierën e tyre në një treg pune që transformohet çdo ditë. Fakulteti ynë nuk është një ishull i izoluar, as një kështjellë me mure rrethuese të ngritura mbi autoreferencë. Përkundrazi, ne besojmë se një fakultet i shkencave të aplikuara dhe industrive kreative duhet të jetë si një far: një dritë që ndriçon dijen, përcjell besim, afron varkat dhe anijet drejt tij, por njëkohësisht i lejon të largohen të lira për të eksploruar arkipelagë idesh, dete të reja sfidash dhe oqeanë të mundësive profesionale.

Ne jemi gjithmonë të hapur për t'i mirëpritur kur kthehen, më të formuar, më të sigurt dhe më të pasuruar. Forca jonë më e madhe është stafi ynë: arkitektë, projektues, artistë, studiues dhe profesionistë të njohur në industrinë kreative dhe në akademi.

Ata sjellin në auditor kulturë profesionale, eksperiencë ndërkombëtare, pasion për dijen dhe dedikim për rritjen e çdo studenti.



Atje ku teknologjia takon krijimtarinë.

DEPARTAMENTI I SHKENCAVE TË APLIKUARA DHE KOMPJUTERIKE

Bachelor

- Informatikë e Aplikuar
- Shkenca Kompjuterike
- Biznes Dixhital

Master i Shkencave

- Informatikë e Aplikuar
- Inteligjencë Artificiale dhe Siguria Kibernetike

Diplomë Profesionale

- Teknik për Pajisjet Elektronike dhe TIK
- Teknik i Sistemeve dhe Rrjetave Kompjuterike



DEPARTAMENTI I ARKITEKTURËS DHE DIZAJNIT

Bachelor / Program i Integruar

- Arkitekturë (5 vjet – Program i Integruar)



Master i Shkencave

- Arkitekturë (5 vjet – Program i Integruar)

DEPARTAMENTI I INDUSTRIVE KREATIVE

Bachelor

- Dizajn interieri dhe produkti

* Program i integruar 5-vjeçar
"Master i Shkencave" në Arkitekturë.





Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit

Mesazhi i dekanit

Prof. Dr. Artan Shyti

Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit ofron programe studimi në fusha të aktivitetit shoqëror, që po marrin një rëndësi gjithnjë e më të madhe për shoqërinë shqiptare dhe më gjerë.

Në këtë fakultet, departamentet paraqesin mundësi që studentët të diplomohen në fusha si: shkencat e edukimit, psikologji, punë sociale, turizëm, edukim fizik dhe sport, të cilat po evidentohen gjithnjë e më tepër si aspekte të rëndësishme të jetës shoqërore, si hapësira punësimi që përfshijnë gjithnjë e më shumë interesimin e njerëzve dhe kërkojnë specialistë të kualifikuar. Në përgjigje të kësaj kërkesë gjithnjë në rritje, fakulteti ynë është angazhuar në ofrimin e programeve studimi moderne, interesante dhe efikase, që përgatisin profesionistë të projektuar në trendin e zhvillimit perspektiv të shoqërisë, në planin kombëtar dhe ndërkombëtar.

I gjithë stafi akademik i fakultetit synon të vendosë dhe zbatojë standarde bashkëkohore të formimit të specialistëve të lartë në këto fusha, të cilët të jenë në gjendje të ballafaqohen denjësisht me kërkesat e tregut të punës.

Një tjetër aspekt i punës në fakultetin tonë është organizimi i trajnimeve profesionale si një element që po merr një rëndësi të veçantë në formimin profesional afatgjatë në të gjitha fushat.



Ku pasioni për njerëzit, lëvizjen dhe udhëtimet bëhet profesion.

DEPARTAMENTI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTEVE

Bachelor

- Edukim Fizik dhe Sporte

Master i Shkencave

- Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte

DEPARTAMENTI I TURIZMIT, MIKPITJES DHE REKREACIONIT

Bachelor

- Menaxhim në Turizëm, Rekreacion dhe Evente

Master Profesional

- Menaxhim Turizëm, Mikpritje dhe Rekreacion

DEPARTAMENTI I SHKENCAVE TË SJELLJES DHE SHËNDETIT

Bachelor

- Psikologji

Diplomë Profesionale

- Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore

Master i Shkencave

- Psikologji Shkollore dhe Zhvillimi
- Psikologji Klinike
- Punë Sociale në Sistemin Arsimor



DEPARTAMENTI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT DHE TRAJNIMIT PROFESIONAL

Master Profesional

- Mësimdhënia dhe të Nxënit
- Mësuesi në Shkenca Sociale
- Mësuesi në Teknologji Informacioni dhe Komunikim
- Mësuesi në Gjuhë dhe Komunikim
- Mësuesi në Arte
- Arsimit Special



Fakulteti i Shkencave Mjekësore

Mesazhi i Dekanes:

Prof. Dr. Evda Veveçka

Mirë se vini në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, Universiteti Barleti!

Në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, çdo student është pjesë e një komuniteti që ndërton profesionalizëm, integritet dhe kujdes për jetën. Identiteti ynë akademik është përkushtimi ndaj cilësisë dhe shërbimit dhe, së bashku, do ta forcojmë edhe më tej. Në planin tonë të ri strategjik, rezultat i një reflektimi dhe mobilizimi kolektiv ambicioz, parashikohet ofrimi i programeve në dy gjuhë (shqip dhe anglisht), me një mision të qartë: të promovojmë përsosmërinë në mësimdhënie, kërkimin shkencor dhe shërbimin në komunitet, në një mjedis dygjuhësh, të larmishëm dhe gjithëpërfshirës.

Ne ju mirëpresim në komunitetin tonë të profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe gjithmonë do t'ju mbështesim në rrugëtimin tuaj drejt suksesit.



Formojmë profesionistët që shërojnë të ardhmen.

DEPARTAMENTI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE

Bachelor

- Infermieri
- Fizioterapi



DEPARTAMENTI I SHKENCAVE MJEKËSORE DHE TË SHËNDETIT

Diploma të Integruara

- Farmaci (5 vjet – Program i Integruar)
- Stomatologji (5 vjet – Program i Integruar)



DEPARTAMENTI I FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM DHE ZHVILLIMIT PROFESIONAL

Ky departament ofron programe formimi të vazhduar, trajnime afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për infermierë, fizioterapistë, stomatologë dhe farmacistë në sektorin publik dhe privat, në funksion të zhvillimit të tyre profesional gjatë gjithë jetës.



BARLETI

Poliklinika Universitare



Poliklinika Universitare Barleti

Partneri juaj në formim dhe kujdes shëndetësor.

Poliklinika Universitare Barleti u krijua fillimisht si mbështetje konkrete për Fakultetin e Shkencave Mjekësore, me qëllimin t'u ofrojë studentëve të infermierisë, fizioterapisë, farmacisë dhe stomatologjisë mundësinë të zhvillojnë praktikën në kushte reale pune.

Nën udhëheqjen e mjekëve specialistë dhe stafit akademik, studentët përfshihen në procesin e diagnostikimit, trajtimit dhe kujdesit ndaj pacientëve, duke fituar siguri profesionale, aftësi praktike dhe një avantazh të qartë në tregun e punës.

Sot, Poliklinika Universitare Barleti është një qendër moderne mjekësore multidisciplinare, e gjeneruar mbi parimet e parandalimit, diagnostikimit të hershëm dhe trajtimit efektiv.

Ekipi ynë përbëhet nga mjekë specialistë, teknikë dhe kërkues shkencorë që kombinojnë përvojën klinike me teknikat dhe terapitë më bashkëkohore. Pajisjet e avancuara diagnostikuese, sistemet dixhitale të menaxhimit të të dhënave mjekësore dhe ambientet funksionale garantojnë standarde të larta cilësie.

Shërbimet tona përfshijnë:

Specialitete mjekësore: kardiologji, angiologji, ortopedi & traumatologji, pneumologji, endokrinologji, alergologji, gastrohepatologji, nefrologji, reumatologji, neurologji, geriatri, gjinekologji & obstetrikë, mjekësi interne, pediatri, etj.

Kabinete të specializuara dhe klinikë dentare

Klinikë estetike

Kabinet rehabilitimi

Laborator mjekësor

Imazheri

Farmaci



Agjencia e Shëndetit në Familje

Një risi e rëndësishme është Agjencia e Shëndetit në Familje, e cila ofron kujdes të integruar shëndetësor dhe social në shtëpinë e pacientit, 24/7, përmes një ekipi multidisiplinar mjekësh, infermierësh, fizioterapistësh dhe profesionistësh të tjerë të fushës.

Poliklinika Universitare Barleti është një pikë takimi mes arsimit, kërkimit dhe praktikës klinike — një laborator real për formimin e studentëve dhe një adresë e sigurt për çdo pacient që kërkon kujdes cilësor, profesionalizëm dhe komoditet.

Shëndeti dhe mirëqenia juaj janë prioriteti ynë.



Poliklinika



Agjencia e Shëndetit
në Familje





Universiteti Barleti

APLIKO

+355 69 20 67 247

Tiranë, Rruga Frang Bardhi, Selitë

info@umb.edu.al




Në Barlet, studimet janë të lidhura ngushtë me praktikën, biznesin dhe sfidat reale të tregut të punës. Programet ndërtohen duke pasur parasysh profesionet e së nesërme: studentët punojnë me projekte konkrete, angazhohen në kërkim të aplikuar dhe bashkëpunojnë me kompani, institucione dhe organizata partnere.

Kampusi modern, laboratorët e specializuar, Poliklinika Universitare, Maker Space, qendrat e karrierës dhe nismat e sipërmarrjes krijojnë një ekosistem ku ideja kthehet në veprim. Studentët nuk janë thjesht pjesëmarrës në leksione, por aktorë aktivë në formimin e tyre akademik dhe profesional.

Në Barlet, studentët përfitojnë:

- Programe studimi me fokus praktik dhe projekte reale
- Mundësi praktikash dhe punësimi përmes rrjetit të gjerë të partnerëve
- Laboratorë, Poliklinikë, Maker Space dhe ambiente bashkëkohore mësimdhënieje
- Mbështetje nga Zyra e Karrierës dhe Alumni për hapat e parë në tregun e punës
- Aktivitetete, trajnime dhe nisma sipërmarrëse që nxisin kreativitetin dhe inovacionin



JETA STUDENTORE

“Barletas” është emri i dytë i çdo studenti që ndjek studimet e tij në UniBa.

Dekani i Studentëve është mbështetja e parë në çdo aktivitet që organizojnë Barletasit, brenda dhe jashtë kampuseve.

Misioni i këtyre aktiviteteve është të pasurojnë zhvillimin intelektual, etik dhe social të studentëve në UniBa, duke i angazhuar ata më shumë në komunitet, si dhe duke nxitur e zhvilluar shprehi dhe aftësi drejtuese e organizative.

Klubet Studentore në universitetin tonë janë ngritur dhe ndërtuar mbi baza akademike, të cilat kanë në plan të parë orientimin e studentit, përshtatjen e tij me jetën studentore dhe, njëkohësisht, pasurimin dhe zbulimin e saj.

Pjesë e Klubeve Studentore mund të jenë jo vetëm studentët Barletas, por gjithashtu mirëpresim anëtarësim dhe pjesëmarrje edhe nga gjimnazistë, kolegjistë dhe maturantë nga e gjithë Shqipëria, të cilët mund të zgjedhin secilin klub në bazë të interesave të tyre dhe ta përdorin përvojën e fituar në këto klube në karrierën e tyre të ardhshme akademike dhe profesionale.

Studentët e diplomuar, apo Alumni, gjithashtu mund të marrin pjesë si anëtarë nderi në këto klube, duke dhënë kontributin e tyre përmes eksperiencës së mëparshme.

UniBA nëpërmjet **10 klubeve studentore** krijon një komunitet gjithëpërfshirës, kreativ dhe sipërmarrës.

MENAXHIM, BIZNES, FINANCË
DHE MARKETING

KLUBI I VULLNETARËVE

SHKENCA SOCIALE, PSIKOLOGJI,
EDUKIM, PUNONJES SOCIAL

SHKENCA KOMPJUTERIKE
DHE INFORMATIKË

ARKITEKTURË, DIZAJN DHE ARTE
TË APLIKUARA

KLUBI I KARRIERËS

MJEKËSI, INFIERMIERI, FARMACEUTIKE,
STOMATOLOGJI, FIZIOTERAPI

SPORT, NUTRICION DHE TURIZËM

DREJTËSI DHE MIRËQEVERISJE

Dr. Elda Mamoçi

Dekane e Studentëve
Lektore në Universitetin Barleti





klubet_studentore



#aktivitete #klube
#miqësi #zhvillim

ZYRA E KARRIERËS

Që nga ditët e para në universitet deri te hapat e parë në tregun e punës, Zyra e Karrierës është partneri kryesor i studentëve në ndërtimin e një rruge profesionale të suksesshme.



Msc. Sara Arena

Përgjegjëse e Zyrës së Karrierës

“

Si drejtuese e Zyrës së Karrierës, besoj se çdo student ka potencial të jashtëzakonshëm.

Çdo ditë kjo zyrë angazhohet t’ju ofrojë mbështetjen dhe orientimin që ju nevojitet për të ndërtuar një karrierë sa më të sigurt.

Synimi kryesor i Zyrës së Karrierës është t’ju shoqërojë në çdo hap të rrugëtimit tuaj profesional, duke filluar që nga ndërtimi i një CV-je, këshillimi i vazhdueshëm profesional, informimi për praktika dhe punësim, trajnime për aftësitë që kërkon tregu i punës, e deri edhe në një punësim të mundshëm.

Kjo njësi e këshillimit të karrierës është këtu për t’ju ndihmuar të zbuloni aftësitë që keni, mundësitë profesionale që ju presin dhe t’ju ndihmojë të ecni me besim drejt së ardhmes suaj. “

Kjo zyrë:

- Ofron këshillim individual për orientimin në karrierë dhe zgjedhjen e profilit profesional.
- Ndihmon studentët në përgatitjen e CV-së, letrës së motivimit dhe intervistave të punës.
- Informon në mënyrë të vazhdueshme për praktika profesionale, punësime dhe mundësi trajnimi.
- Bashkëpunon me kompani, institucione dhe organizata për të lidhur studentët me tregun real të punës.
- Organizon panairin vjetor të punës dhe aktivitete networking-u që afërsojnë studentët me punëdhënësit.



ZYRA ALUMNI

Zyra Alumni është ura që lidh studentët me universitetin edhe pasi kapitulli i studimeve ka përfunduar. Ne besojmë se alumni janë pjesa më e qëndrueshme e familjes Barleti, ndaj kujdesemi të mbajmë komunikim të vazhdueshëm, të ndjekim historitë e tyre të suksesit dhe t'i rikthejmë në aktivitetet akademike profesionale dhe sociale të universitetit.

Ne krijojmë hapësira ku ish-studentët mund të ndërtojnë rrjete të reja profesionale, të kontribuojnë me eksperiencën e tyre dhe të shërbejnë si frymëzim për brezat e rinj. Përmes eventeve, panelëve, leksioneve të ftuara dhe bashkëpunimeve me departamentet, Zyra Alumni ndërton një komunitet aktiv që rritet dhe zhvillohet bashkë me universitetin.



Irisi Asa

Përgjegjëse e Zyrës Alumni

Si përgjegjëse e Zyrës Alumni, synimi im është të mbaj lidhjen me ish-studentët tanë aktive, të qëndrueshme dhe të vlefshme për zhvillimin e tyre profesional. Përmes aktiviteteve, rrjeteve dhe bashkëpunimeve, unë punoj çdo ditë që alumni të mbeten pjesë e familjes Barleti dhe të kthehen si shembuj frymëzues për brezat që vijnë.



Barleti Skills Academy Albania



Barleti Skills Academy Albania është qendër trajnimesh, kursesh, konsulencash, testimesh dhe certifikimesh, me një kompetencë dhe ekspertizë të gjerë në një serë fushash, profesionesh, sektorësh, profilesh profesionale dhe sociale.

Kurset, trajnimet dhe certifikimet janë të licensuara dhe akredituara dhe të njohura nga institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare duke mbështetur studentët të kenë njohuritë, aftësitë dhe certifikimet e duhura, për të spikatur dhe qenë të suksesshëm në karrierën e tyre.



STARTUP
Bootcamp



DREJTËSIA SOCIALE
DHE SUNDIMI I LIGJIT

STEAM+
SCIENCE • TECHNOLOGY • ENGINEERING • ARTS • MATHEMATICS
ALBANIA

KONKURSET KOMBËTARE NË KUADËR TË SFIDAVE

DIGITAL FUTURE – HACKATHON

CREATHON – INDUSTRIË KREATIVE

BARLETI STARTUP - BOOTCAMP

SMART CITY CHALLENGE

DIGIHEALTH – INDUSTRIA E SHENDETIT

STEAM+ – INOVACION

LIGJI DHE KOHEZIONI SOCIAL

CREATIVE BUSINESS CUP



IRO ZYRA E MARRËDHËNIEVE NDËRKOMBËTARE

Në Universitetin "Barleti", bota është pjesë e jona. Përmes Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare (IRO), UniBa ndërton ura me universitete, organizata dhe biznese në Evropë e më gjerë, duke e kthyer studimin në Barleti në një përvojë me perspektivë reale ndërkombëtare.

Duke u mbështetur në kapacitetet e Katedrës Jean Monnet dhe Kryesisë së UNESCO-s, universiteti zhvillon projekte, shkëmbime dhe bashkëpunime në fusha si ekonomia, drejtësia, shkencat sociale e politike, administrata publike, arsimi, sporti, arkitektura, IT, inxhinieria dhe formimi i mësuesve.

Erasmus+ & Marrëveshje Bashkëpunimi

Falë marrëveshjeve të shumta Erasmus+ dhe memorandumeve të mirëkuptimit (MoU), studentët e Barletit kanë mundësi të studiojnë të paktën një semestër në një nga universitetet partnere në Evropë dhe rajon. Çdo semestër, Barleti dërgon studentë jashtë vendit dhe pret studentë të huaj në kampusin e tij, duke krijuar një ambient ndërkulturor dhe një dinamikë të re mësimi.



300+

Studentë & staf
në mobilitet Erasmus+



15+

Shtete partnere

Spanje, Itali, France, Portugali,
Gjermani, Hollande, Hungari,
Bullgari, Poloni, Turqi, etj

INSTITUTET DHE KËRKIMI

Institutet që veprojnë nën ombrellën e Universitetit Barleti realizojnë dhe promovojnë kërkime shkencore të aplikuara me cilësi të lartë. Si pjesë e axhendës për modernizimin e arsimit të lartë në Shqipëri, institutet synojnë të ndihmojnë universitetin të përmbushë kërkesat e standardeve dhe kritereve të sistemit evropian të sigurimit të cilësisë.



Instituti Shqiptar për Çështjet Publike – AIPA

AIPA ka 11 vite që punon për të promovuar parimet e demokracisë, qeverisjes së mirë dhe meritokracisë, duke kontribuar në hartimin, përmirësimin dhe zbatimin e një sërë ligjesh dhe reformash në vend.



Instituti Adriapol (Instituti për Rritje të Zgjuar dhe Kreative)

Fokusi i Institutit Adriapol është sipërmarrja dhe konkurrueshmëria, përmes rritjes së kapaciteteve për Startupe të qëndrueshme dhe inovacion të vazhdueshëm.



BIRD (Instituti Barleti i Kërkimit dhe Zhvillimit)

Misioni i BIRD është të jetë një qendër ekselence për kërkime ndërdisiplinore dhe multidisiplinore në fusha ekonomike, shkencore dhe teknologjike.



Shoqata Barleti: Mirëqenie, Edukim, Sport dhe Turizëm

Shoqata Barleti është një organizatë jofitimprurëse që synon të promovojë sportin, aktivitetet fizike, rekreacionin, turizmin dhe të edukojë komunitetin për rëndësinë që kanë këto aktivitete në përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies, si dhe në adoptimin e një stili jetese të shëndetshëm.



Youth Act

Vizion i qendrës Youth Act është fuqizimi i të rinjve si promotorë të zhvillimit të vendit, dhe synimi është të jetë një urë lidhëse mes Shqipërisë dhe komunitetit ndërkombëtar për zhvillimin dhe integrimin e rinisë shqiptare në botën e globalizuar.



Qendra Barleti e Trajnimit dhe Testimit – BTTC

BTTC është një qendër trajnimi, kualifikimi, testimi dhe certifikimi për arsimin dhe formimin gjatë gjithë jetës. Qendra mbulon të gjitha format e të nxënimit për zhvillimin profesional praktik.



Shoqata Barleti

PROGRAMET KRYESORE

BASECAMP

Zinxhiri i Vlerës
në Industrinë e Sportit

LABORATORI JETËSOR

Shëndet,
Sport dhe Mirëqenie

THE NET

Shërbimi
dhe Mbështetja Sociale

SAMKO

Sporti Amator
dhe Korporativ

SPORTI NË SHKOLLA DHE KOMUNITET

Promovimi i sportit
në shkollë dhe komunitet

AKADEMIA PROFESIONALE BARLETI

Zhvillimi profesional i punonjësve
në industrinë e sportit





2036
2035
2034
2033
2032
2031
2030
2029
2028
2027
2026



2025

20 vite UniBA



2024
2023
2022
2021
2020
2019
2018
2017
2016
2015
2014
2013
2012
2011
2010
2009
2008
2007
2006

2005

Historia nis këtu

